

RAPORT I PËRKOHSHËM 5 shtator–1 tetor 2025

3 tetor 2025

I. PËRMBLEDHJE E SHKURTËR

- Zgjedhjet lokale në Maqedoninë e Veriut do të mbahen më 19 tetor. Votuesit do të zgjedhin kryetarët dhe këshillat e 80 komunave dhe të Qytetit të Shkupit. Zgjedhjet e mundshme të rrethit të dytë për kryetar komune do të mbahen më 2 nëntor. Zgjedhjet po zhvillohen në një mjedis politik që vazhdon të jetë i polarizuar, edhe përgjatë vijave etnike. Pakënaqësia publike ndaj institucioneve dhe perceptimet për korrupsion e përbëjnë sfondin e këtyre zgjedhjeve. Çështjet e identitetit kombëtar dhe përfaqësimit të komuniteteve etnike kanë dominuar diskursin publik, së bashku me debatet mbi reformat e nevojshme për avancimin në procesin e integritetit në Bashkimin Evropian.
- Zgjedhjet lokale përcaktohen kryesisht nga Kushtetuta, Kodi Zgjedhor, si dhe aktet nënligjore të Komisionit Shtetëror Zgjedhor (KSHZ). Megjithëse ndryshimet e Kodit Zgjedhor të vitit 2024 trajtuan disa rekomandime të mëparshme të ODIHR-it, shumica e tyre mbeten të patrajuara. Në maj, Gjykata Kushtetuese shfuqizoi dispozitat mbi nënshkrimet mbështetëse për kandidatët e pavarur; KSHZ-ja e rregulloi këtë aspekt duke kërkuar vetëm dy nënshkrime, pasi parlamenti nuk arriti të plotësojë boshllëkun ligjor. Dispozitat ligjore për reklamimin politik në media, duke përfshirë mediat online, dhe për reklamimin në hapësira publike i vënë në disavantazh strukturor kandidatët e pavarur dhe partitë jo-parlamentare, si dhe i përjashtojnë disa parti parlamentare.
- Zgjedhjet administrohen nga KSHZ-ja, 81 Komisione Zgjedhore Komunale (KZK), duke përfshirë Komisionin Zgjedhor të Qytetit të Shkupit, dhe 3.480 Këshilla Zgjedhorë (KZ). Përgatitjet teknike për zgjedhjet janë në zhvillim e sipër dhe po vazhdojnë pa vonesa të mëdha. Megjithatë, KZK-të, përgjegjëse për emërimin e përbërjes së re të përhershme të KZ-ve, raportuan sfida dhe vonesa në procesin e përzgjedhjes. KSHZ-ja mban mbledhje *ad hoc* që janë të hapura për vëzhguesit, mediat dhe përfaqësuesit e autorizuar të kandidatëve dhe ato transmetohen online.
- Të gjithë qytetarët e moshës 18 vjeç e lart kanë të drejtë vote, përveç atyre që u është hequr e drejta juridike me vendim përfundimtar të gjykatës ose që janë të dënuar për vepra të caktuara penale. Regjistri i centralizuar i votuesve (RV) i përfshin të dhënat e rreth 1.83 milion qytetarëve me të drejtë vote, nga të cilët rreth 1.72 milion me vendbanim të përhershëm në vend do të përfshihen në listat e votuesve. RV-ja ishte e hapur për shqyrtim publik, duke përfshirë edhe nga kandidatët zgjedhorë. Bashkëbiseduesit e Misionit për Vëzhgimin e Zgjedhjeve të ODIHR-it vunë në dukje shqetësimet e kahershme lidhur me numrin e konsiderueshëm të votuesve që nuk banojnë në vendbanimin e tyre të përhershëm, por jashtë vendit, si dhe se mangësitë në sistemin e adresave të banimit mund të ndikojnë negativisht në saktësinë e regjistrimit të votuesve.
- Qytetarët me të drejtë vote mund të kandidojnë në komunën e tyre të vendbanimit të përhershëm, përveç ato që janë duke vuajtur ose presin të vuajnë dënime me burgim mbi gjashtë muaj. Kandidatët mund të emërohen nga partitë politike dhe koalicionet, ose nga grupet e votuesve. Kërkesa për të kontrolluar dosjet penale të kandidatëve përmes gjykatave themelore iu raportua MVZ-së së ODIHR-it si e rënduar dhe, nganjëherë, shkaktoi vonesa. KZK-të regjistruan gjithsej 577 lista këshilltarësh, të gjitha në përputhje me kuotën gjinore, dhe 309 kandidatë për kryetar komune, duke përfshirë 32 gra (10,4 për qind). KZK-të refuzuan regjistrimin e gjashtë kandidatëve për kryetar komune dhe katër listave për këshilla komunale.

- Periudha zyrtare e fushatës zgjat nga 29 shtatori deri më 17 tetor. Ndërkohë që zhvillimi i fushatës është i ndaluar para afatit zyrtar, disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it theksuan se disa kandidatë për kryetar komune u angazhuan në aktivitete të fushatës para periudhës zyrtare. Megjithatë ekzistojnë rregulla të rrepta që synojnë parandalimin e keqpërdorimit të burimeve publike ose keqpërdorimin e detyrës zyrtare që nga dita e shpalljes së zgjedhjeve, shumë bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it shprehën shqetësime në lidhje me keqpërdorimin e mundshëm të burimeve shtetërore dhe presionin ndaj punonjësve publikë, si dhe disa raste të pretenduara të frikësimit të votuesve.
- Fushata në rrjetet sociale mbetet kryesisht e parregulluar, dhe nuk ka mbikëqyrje rregullatore. Shumica e garuesve deklaruan se do të mbështeteshin pjesërisht në rrjetet sociale për zhvillimin e fushatës, por disa garues shprehën shqetësime lidhur me sulmet e mundshme verbale online ndaj kandidatëve dhe mbështetësve të tyre. Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike hartoi një Kod vullnetar të Sjelljes në Hapësirën Online gjatë Proceseve Zgjedhore dhe Referendumeve, që e trajton reklamimin politik, dezinformimin dhe përpunimin e të dhënave personale.
- Ligji përcakton një kuotë gjinore prej 40 për qind për listat e kandidatëve, me kërkesa specifike për renditjen e tyre. Në organet e administratës zgjedhore, secila gjini duhet të përfaqësohet me të paktën 30 për qind. Megjithatë presidentja aktuale është një grua, gratë mbeten të nën-përfaqësuara në jetën publike dhe politike. Gratë përbëjnë 40 për qind të deputetëve dhe mbajnë 3 nga 23 pozicione ministrore. Nga 81 kryetarë të komunave të zgjedhur në vitin 2021 vetëm 2 janë gra. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it shprehën shqetësime në lidhje me retorikën mizogjine kundër kandidateve gra dhe pjesëmarrjes politike të grave në përgjithësi, veçanërisht në internet.
- Fushatat mund të financohen nga burime publike dhe private. Nuk ka financim të drejtpërdrejtë publik për fushatën, por partitë që marrin fonde nga shteti mund t'i përdorin ato për qëllime të fushatës. Ligji vendos kufizime për donacionet dhe shpenzimet, ndalon burime të caktuara të financimit dhe parashikon sanksione për shkeljet në financimin e fushatës. Kandidatët duhet të dorëzojnë raporte financiare të përkohshme dhe përfundimtare, por vetëm raportet përfundimtare i nënshtrohen revizionit. Shumë bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it shprehën shqetësime në lidhje me efektivitetin e mbikëqyrjes së financimit të fushatës dhe keqpërdorimin e burimeve administrative, duke përmendur boshllëqet ligjore dhe kapacitetin e kufizuar të organeve mbikëqyrëse.
- Mediat janë të fragmentuara përgjatë vijave politike dhe etnike dhe funksionojnë në një treg të kufizuar reklamash. Kodi Zgjedhor kërkon që mediat t'i mbulojnë zgjedhjet në mënyrë të drejtë, të balancuar, dhe të paanshme. Gjatë periudhës zyrtare të fushatës, edicionet e lajmeve të transmetuesit publik rregullohen me rregulla të hollësishme. Reklamimi politik në media, duke përfshirë edhe në ato online, kompensohet nga buxheti i shtetit. Transmetuesit kombëtarë duhet të bëjnë të paktën një edicion ditor lajmesh dhe një program javor në kohën me shikueshmëri më të madhe, që do të jenë të qasshëm për personat me aftësi të kufizuara.”
- Shumica e ankesave që lidhen me zgjedhjet mund të parashtrihen vetëm nga garuesit, pranë komisioneve zgjedhore ose gjykatave themelore, varësisht nga çështja. Votuesit mund të parashtrojnë ankesa vetëm në lidhje me keqpërdorimin e burimeve administrative ose me shkeljen e të drejtave të tyre individuale të votimit. Ligji parashikon afate të shkurtra për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesave. Gjykata Kushtetuese shqyrtoi disa iniciativa në lidhje me këto zgjedhje dhe i hodhi poshtë të gjitha, ndërsa Gjykata Administrative deri më tani ka shqyrtuar dy ankesa, duke i

konfirmuar vendimet e KZK-ve për refuzimin e kandidaturave. Shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it shprehën besim në efikasitetin e sistemit të zgjidhjes së kontesteve, megjithëse disa prej tyre shprehën shqetësime në lidhje me paanshmërinë dhe pavarësinë e organeve gjyqësore.

- Kodi Zgjedhor parashikon vëzhgimin vendas dhe ndërkombëtar të zgjedhjeve, duke përfshirë edhe vëzhguesit qytetarë dhe përfaqësuesit e autorizuar të garuesve. Aktivitetet e vëzhgimit nga organizatat qytetare vëzhguese janë shumë të kufizuara për shkak të mungesës së financimit.

II. HYRJE

Në përgjigje të ftesës nga autoritetet e Republikës së Maqedonisë së Veriut për t'i vëzhguar zgjedhjet lokale të 19 tetor të vitit 2025 dhe në bazë të rekomandimeve të Misionit të Vlerësimit të Nevojave të zhvilluar nga 24 deri më 27 qershor, Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e OSBE-së (ODIHR) më 5 shtator e krijoi Misionin për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ).¹ Misioni i udhëhequr nga Matteo Mecacci, përbëhet nga 14 anëtarë të ekipit kryesor në Shkup dhe 24 vëzhgues afatgjatë, të cilët më 13 shtator u shpërndanë në 11 lokacione në mbarë vendin. Anëtarët e misionit vijnë nga 24 shtete pjesëmarrëse të OSBE-së, dhe 53 për qind e anëtarëve të misionit janë gra. ODIHR u ka kërkuar Shteteve pjesëmarrëse që të dërgojnë 250 vëzhgues afatshkurtër për të vëzhguar procedurat e ditës së zgjedhjeve.

III. SFONDI DHE KONTEKSTI POLITIK

Më 9 gusht, Kryetari i Parlamentit i shpalli zgjedhjet lokale për 19 tetor, me zgjedhje të mundshme të rrethit të dytë për kryetarë komunash që do të zhvillohen më 2 nëntor. Në zgjedhjet e fundit lokale në vitin 2021, koalicioni i udhëhequr nga Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike e Unitetit Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) siguroi kontrollin në shumicën e komunave dhe në Qytetin e Shkupit, ndërsa Lidhja Social Demokratike e Maqedonisë (LSDM) pësoi humbje të konsiderueshme, gjë që çoi në dorëheqjen e Kryeministrit Zoran Zaev.² Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, VMRO-DPMNE-ja fitoi numrin më të madh të deputetëve dhe formoi një qeveri me VLEN-in, një koalicion i partive politike etnike shqiptare, dhe “Për Maqedoninë Tonë” (ZNAM).³ Në zgjedhjet presidenciale, Gordana Siljanovska-Davkova, e mbështetur nga VMRO-DPMNE-ja, u zgjodh në rrethin e dytë të mbajtur më 8 maj të vitit 2024, duke u bërë gruaja e parë kryetare në krye të shtetit.

Skena politike mbetet e polarizuar, duke përfshirë edhe përgjatë vijave etnike. Diskursi publik është dominuar nga çështjet që lidhen me identitetin kombëtar dhe të drejtat e komuniteteve etnike, si dhe nga debatet mbi ndryshimet kushtetuese në pritje dhe reformat e nevojshme për përparimin në negociatat për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE). Përveç kësaj, çështjet legjislative që janë relevante për komunitetet etnike, siç është kontestimi i kushtetutshmërisë së Ligjit për Përdorimin e

¹ Shih [raportet e mëparshme të ODIHR-it për zgjedhjet në Maqedoninë e Veriut](#).

² Nga 80 komunat dhe Qyteti i Shkupit, VMRO-DPMNE fitoi në 42 gara për kryetarë komunash, ndërsa LSDM-ja siguroi 16 kryetarë komunash. Bashkimi Demokratik për Integritet (BDI) i shqiptarëve etnikë fitoi 11 vende për kryetarë komunash, i ndjekur nga Aleanca për Shqiptarët (ASH) dhe Lëvizja Besa (Besa) me nga 2 vende kryetarësh të komunave, dhe Partia Demokratike e Shqiptarëve (PDSH) me 1 kryetar komune. Koalicioni Partia Liberal Demokratike – Rindërtimi Demokratik i Maqedonisë (PLD–DOM) dhe Opsioni Qytetar për Maqedoninë (GROM) fituan nga një garë për kryetar komune, ndërsa kandidatët e pavarur dhe të tjerët fituan gjithsej katër kryetarë komunash. VMRO-DPMNE-ja fitoi 468 mandate në këshillat komunale, LSDM siguroi 396, BDI-ja 169, ASH-ja 82, kandidatët e pavarur dhe të tjerët 72, Levica 49, Besa 36, koalicioni PLD-DOM 27, Partia Demokratike e Turqve 16, PDSH-ja 8 dhe GROM-i 2.

³ Në zgjedhjet parlamentare të vitit 2024, koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja siguroi 58 mandate deputetësh, BDI-ja dhe koalicioni i udhëhequr nga LSDM-ja fituan nga 18 mandate, VLEN-i fitoi 14 mandate, ndërsa ZNAM-i dhe Levica fituan nga 6 mandate.

Gjuhëve që është në shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese, si dhe përfaqësimi i barabartë i personave që u përkasin të gjitha komuniteteve në të gjitha institucionet publike dhe në fusha të tjera të jetës publike, përbëjnë një pjesë të rëndësishme në sfondin e këtyre zgjedhjeve. Pakënaqësia publike ndaj institucioneve në të gjitha nivelet dhe perceptimet për korrupsion të përhapur mbeten të pranishme.⁴ Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it vunë në dukje se pas zjarrit tragjik në një klub nate në Koçan në mars të vitit 2025, perceptimet për përgjegjësi të pamjaftueshme dobësuan më tej besimin e publikut ndaj institucioneve.⁵

Gratë mbeten të nënpërfaqësuar në jetën publike dhe politike. Gratë aktualisht përbëjnë 48 nga 120 deputetët në parlament (40 për qind) dhe mbajnë vetëm 3 nga 23 pozicione ministrore (13 për qind). Nga 81 kryetarë të komunave të zgjedhur në vitin 2021, vetëm 2 janë gra. Megjithëse parlamenti në vitin 2006 miratoi Ligjin për Mundësi të Barabarta për Gratë dhe Burrat dhe qeveria në korrik të vitit 2022 miratoi Strategjinë Kombëtare për Barazi Gjinore (2022–2027), bashkëbiseduesit theksuan mungesën e përpjekjeve kuptimplote për promovimin e grave brenda strukturave udhëheqëse të partive, duke potencuar se stereotipet gjinore, përfaqësimi i kufizuar në media dhe mungesa e mbështetjes financiare ose logjistike mbeten pengesat kryesore për pjesëmarrjen e plotë politike të grave.

IV. KORNIZA LIGJORE DHE SISTEMI ZGJEDHOR

Zgjedhjet lokale përcaktohen kryesisht nga Kushtetuta e vitit 1991, Kodi Zgjedhor i vitit 2006, si dhe aktet nënligjore të miratuara nga Komisioni Shtetëror Zgjedhor (KSHZ).⁶ Kodi Zgjedhor u ndryshua së fundmi pak para zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale të vitit 2024. Ndër ndryshimet e tjera, amendamentet trajtuan disa nga rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it, duke përfshirë sqarimin e afateve kohore dhe kushteve për përsëritjen e zgjedhjeve për kryetarë komune, si dhe rishikimin e formulës për përcaktimin e numrit të nënshkrimeve mbështetëse të nevojshme për kandidatët e pavarur në zgjedhjet parlamentare dhe lokale.⁷ Megjithatë, një numër i rekomandimeve të mëparshme të ODIHR-it mbeten të patrajtuara, duke përfshirë ato që lidhen me një rishikim gjithëpërfshirës të Kodit Zgjedhor, sigurimin e qasjes së barabartë në media gjatë fushatave zgjedhore, rritjen e llogaridhënies dhe integritetit të financimit të fushatave, si dhe përforcimin e rregullave për keqpërdorimin e burimeve administrative. Shumë bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it, duke i përfshirë edhe ata nga institucionet shtetërore, theksuan se Kodit Zgjedhor i mungon qartësia dhe e kritikuan praktikën e përsëritur të miratimit të ndryshimeve të fundit pa debat ose konsultim paraprak, gjë që, sipas tyre, kontribuon në pasigurinë juridike dhe e dobëson stabilitetin e ligjit.

Në maj të vitit 2025, duke vepruar mbi iniciativën e një grupi votuesish, Gjykata Kushtetuese shfuqizoi dispozitat e Kodit Zgjedhor që kërkonin që kandidatët e pavarur në zgjedhjet parlamentare dhe lokale të mblidhnin nënshkrime mbështetëse nga një për qind e votuesve të regjistruar në njësinë zgjedhore përkatëse. Gjykata konstatoi se, sipas kësaj formule, numri i kërkuar i nënshkrimeve në 37 nga 80 komunat dhe në Qytetin e Shkupit do të ishte dukshëm më i lartë se në zgjedhjet e mëparshme lokale,

⁴ Shih [Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit të vitit 2024](#) të “Transparency International” dhe [Raportin për Vlerësimin e Korrupsionit në Maqedoninë e Veriut të vitit 2023](#) të Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe raportin [Besimi i Përgjithshëm dhe Besimi në Institucione të vitit 2024](#); dhe [Raportin e Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut të vitit 2024](#).

⁵ Më 16 mars 2025, në një zjarr në një klub nate në Koçan humbën jetën 62 persona dhe u lënduan të paktën edhe 193 të tjerë. Klubi i natës kishte shkelur disa rregullore të sigurisë dhe disa zyrtarë qeveritarë u arrestuan si pjesë e hetimit për lëshimin e licencës së tij. Pas ngjarjes, shpërthyen protesta kundër korrupsionit në të gjithë vendin.

⁶ Korniza rregullatore përfshin gjithashtu Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin për Partitë Politike, Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, Ligjin për Mediat, Ligjin për Shërbimet Audio dhe Audiovizuale Mediatike, si dhe dispozitat përkatëse të Kodit Penal dhe Ligjit për Procedurën Administrative. Maqedonia e Veriut i ka ratifikuar instrumentet kryesore ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut që kanë të bëjnë me mbajtjen e zgjedhjeve demokratike.

⁷ Ndryshimet gjithashtu sqaruan disa rregullore mbi financimin e fushatave, përforcuan mbrojtjen e të dhënave në lidhje me regjistrimin e votuesve, dhe përcaktuan afate për zgjidhjen e kontesteve zgjedhore.

duke krijuar kushte të pabarabarta (shih *Regjistrimi i kandidatëve*). Më 16 gusht, një javë pas shpalljes së zgjedhjeve, tre deputetë paraqitën një iniciativë për të ndryshuar Kodin Zgjedhor me qëllim të adresimit të boshllëkut ligjor të krijuar, por kjo iniciativë nuk u miratua në parlament.⁸

Këshilltarët komunalë dhe kryetarët e komunave zgjidhen drejtpërdrejt për një mandat katërvjeçar, në 80 komunat dhe në Qytetin e Shkupit. Kryetarët e komunave zgjidhen sipas sistemit të shumicës me dy rrethe zgjedhore. Nëse asnjë kandidat nuk fiton shumicën absolute të votave të fituara në rrethin e parë, dy javë më vonë mbahet një balotazh mes dy kandidatëve që kanë fituar më shumë vota. Që zgjedhjet për kryetar komune të jenë të vlefshme, të paktën një e treta e votuesve të regjistruar në komunë duhet të marrin pjesë në rrethin e parë. Nëse ky prag nuk arrihet, zgjedhjet duhet të përsëriten brenda 60 ditëve, pa kërkesë të caktuar për pjesëmarrje.⁹ Kjo kërkesë për pjesëmarrje të votuesve nuk zbatohet për rrethin e mundshëm të dytë ose për zgjedhjet e këshillave komunalë. Këshilltarët zgjidhen përmes sistemit proporcional me lista të mbyllura, pa prag të përcaktuar. Listat e kandidatëve për këshillat komunalë duhet të përfshijnë të paktën 40 për qind kandidatë nga secila gjini, me kërkesa specifike për renditjen e tyre.¹⁰ Numri i këshilltarëve përcaktohet në bazë të popullsisë së komunës, dhe mund të jetë nga 9 deri në 33 këshilltarë, ndërsa 45 anëtarë zgjidhen në Këshillin e Qytetit të Shkupit.¹¹

V. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Zgjedhjet administrohen nga KSHZ-ja, 81 Komisione Zgjedhore Komunale (KZK), duke përfshirë Komisionin Zgjedhor të Qytetit të Shkupit (KZQSh), dhe 3,480 Këshilla Zgjedhorë (KZ).¹² Organet zgjedhore duhet të përmbushin kriteret ligjore për përfaqësimin gjinor dhe etnik: secilës gjini duhet t'i përkasin të paktën 30 për qind e anëtarëve, ndërsa në komunat ku të paktën 20 për qind e qytetarëve i përkasin grupeve etnike jo-shumicë, këto komunitete duhet të përfaqësohen në mënyrë të barabartë.¹³

KSHZ-ja është një organ i përhershëm i emëruar nga parlamenti për një mandat pesëvjeçar. Ai përbëhet nga shtatë anëtarë, nga të cilët katër emërohen nga shumica parlamentare dhe tre nga opozita, bazuar në propozimet e partive politike. Kryetari i KSHZ-së zgjidhet nga radhët e anëtarëve të emëruar nga opozita, ndërsa zëvendëskryetari nga radhët e atyre të propozuar nga shumica.¹⁴ Në përputhje me rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it, para këtyre zgjedhjeve, KSHZ-ja plotësoi disa vende të lira pune, përfshirë pozicionin e sekretarit të përgjithshëm, i cili ishte i paplotësuar disa vite.¹⁵

⁸ Edhe pse 65 deputetë votuan për iniciativën, ajo dështoi pasi nuk siguroi shumicën e dyfishtë të kualifikuar, që kërkohej sipas nenit 5.2 të [Marrëveshjes Kornizë të Ohrit](#) të vitit 2001, i cili, përveç shumicës së përgjithshme, kërkon gjithashtu që shumica e deputetëve nga komunitetet jo-shumicë të votojnë në favor të propozimit.

⁹ Në rast se nuk zgjidhet një kryetar komune, qeveria emëron një përfaqësues për të ushtruar detyrën dhe e njofton Kryetarin e Parlamentit brenda 15 ditëve, për të shpallur zgjedhjet e reja për kryetar komune.

¹⁰ Një nga çdo tre pozicione në listë duhet të jetë i plotësuar me një kandidat të gjinisë më pak të përfaqësuar, me të paktën një vend shtesë për këtë gjini në çdo dhjetë pozicione.

¹¹ Në shtator të vitit 2024, qeveria e përshtati madhësinë e këshillave komunalë në 17 komuna, duke u bazuar në të dhënat e regjistrimit të vitit 2021. Në qershor të vitit 2025, Gjykata Kushtetuese shfuqizoi disa pjesë të metodologjisë së regjistrimit të popullsisë, që do të vlejnin në regjistrimet e ardhshme. Vendimi i qeverisë i shtatorit të vitit 2024 u kundërshtua më pas nëpërmjet tre iniciativave të veçanta para Gjykatës Kushtetuese, e cila më 24 shtator i hodhi poshtë të trija.

¹² Numri dhe vendndodhjet e vendvotimeve u miratuan nga KSHZ-ja më 18 shtator. Sipas KSHZ-së, janë bërë ndryshime minimale në vendndodhjet e vendvotimeve.

¹³ Kërkesat për përkatësinë etnike sigurohen duke përdorur përkatësinë etnike të vetëdeklaruar që është e përfshirë në bazën e të dhënave të nëpunësve publikë si kriter të detyrueshëm gjatë përzgjedhjes së rastësishme të zyrtarëve zgjedhorë.

¹⁴ Ndërsa përbërja aktuale e KSHZ-së u emërua në vitin 2021, përbërja e saj u përshtat në vitin 2025 duke zgjedhur një kryetar dhe zëvendëskryetar të ri. Ky ndryshim u bë i nevojshëm për shkak të ndryshimit të qeverisë si rezultat i zgjedhjeve parlamentare të vitit 2024.

¹⁵ Megjithatë sekretarja e përgjithshme e sapoemëruar është grua, KSHZ-ja ende nuk i përmbahet kërkesës për përfaqësim gjinor, pasi vetëm dy nga shtatë anëtarët e saj aktualë janë gra.

Gjatë periudhës së raportimit, përgatitjet për zgjedhjet që bien nën përgjegjësitë e KSHZ-së për zgjedhjet lokale u ndërmorën pa vonesa të mëdha.¹⁶ KSHZ-ja miratoi udhëzime dhe direktiva të reja ose i ndryshoi ato ekzistuese, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me përdorimin e fondeve nga administrata zgjedhore, përzgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve të KZ-ve, mbledhjen e nënshkrimeve dhe regjistrimin e kandidatëve, si dhe përcaktimin e çmimit mesatar për reklamimin e paguar politik. KSHZ-ja ka mbajtur seanca në bazë *ad hoc* (sipas nevojës). Mediat, vëzhguesit dhe përfaqësuesit e autorizuar të garuesve njoftohen përmes një liste të brendshme që e mban KSHZ-ja, e jo përmes njoftimeve publike siç kërkohet me ligj. Mbledhjet transmetohen në YouTube, ndërsa procesverbalet e mbledhjeve publikohen në faqen e internetit të KSHZ-së. Megjithatë, për shkak të mungesës së një afati të qartë për publikim dhe mbledhjeve jo të shpeshta të KSHZ-së, publikimi i procesverbaleve të mbledhjeve nuk bëhej gjithmonë në mënyrë të shpejtë.¹⁷

Sipas KSHZ-së, për shkak të financimit të kufizuar, masat e qasshmërisë mbeten të kufizuara vetëm në sigurimin e qasshmërisë fizike në vendvotime dhe hapësirat e votimit, ofrimin e disa materialeve informuese në gjuhën e shenjave dhe ofrimin e disa mjeteve ndihmëse, siç janë shabllonet e fletëvotimeve me prekje, në ditën e zgjedhjeve.

KZK-të përbëhen nga kryetari dhe katër anëtarë, të zgjedhur rastësisht nga radhët e punonjësve të shërbimit publik për mandat pesëvjeçar.¹⁸ KZK-të janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit zgjedhor brenda komunave të tyre përkatëse.¹⁹ KZ-të, të cilat janë përgjegjëse për administrimin e procedurave në ditën e zgjedhjeve, formohen sipas një modeli të përzier profesional-politik: tre anëtarë zgjidhen rastësisht nga radhët e punonjësve publikë për një mandat katërvjeçar, ndërsa një anëtar emërohet nga partitë qeverisëse dhe një nga partitë opozitare, të emëruar për çdo zgjedhje. Të gjithë anëtarët e KZK-ve dhe KZ-ve kanë zëvendës, të zgjedhur në të njëjtën mënyrë si edhe përbërja kryesore, të cilët i marrin përsipër të njëjtat të drejta dhe përgjegjësi në mungesë të anëtarëve. Meqenëse mandati i përbërjes së përhershme të KZ-ve skadoi para këtyre zgjedhjeve, anëtarët e rinj të përhershëm duhej të zgjidheshin nga KZK-të paralelisht me përgatitjet e tjera zgjedhore. Shumica e KZK-ve raportuan vonesa dhe sfida në përzgjedhjen e anëtarëve të KZ-ve, e cila u krye për herë të parë duke përdorur softuerin e KSHZ-së.²⁰

Megjithëse me ndryshimet e Kodit Zgjedhor të vitit 2024, në përputhje me një rekomandim të mëparshëm të ODIHR-it, u krijua një Qendër për Edukim të Vazhdueshëm Zgjedhor, njësia për trajnime e KSHZ-së nuk është riorganizuar dhe vazhdon të funksionojë në mënyrën e saj të vjetër.²¹

¹⁶ KSHZ-ja e informoi MVZ-në e ODIHR-it se, megjithëse mori buxhetin e nevojshëm për të mbuluar shpenzimet që lidhen me këto zgjedhje, ekziston një mungesë sistematike e financimit afatgjatë, duke përfshirë investimet për punonjësit dhe infrastrukturën fizike dhe të TIK-ut, gjë që, sipas mendimit të KSHZ-së, ndikon në efikasitetin e operacioneve zgjedhore.

¹⁷ Rregullorja mbi procedurat e brendshme të KSHZ-së parashikon që procesverbalet e mbledhjeve të KSHZ-së të publikohen pasi komisioni të ketë votuar për miratimin e tyre.

¹⁸ Mandati aktual i KZK-ve filloi në vitin 2021. Gratë përbëjnë 49,8 për qind të anëtarëve të KZK-ve dhe 36 nga 81 (44,4 për qind) kryetarët e KZK-ve. Pothuajse 80 për qind e anëtarëve të KZK-ve dhe 48 nga 81 kryetarët e KZK-ve të emëruar në vitin 2021 mbeten në pozicionet e tyre. Rreth tre për qind e pozicioneve të anëtarëve të KZK-ve dhe zëvendësve të tyre janë aktualisht të paplotësuar.

¹⁹ Për zgjedhjet lokale, disa përgjegjësi bien nën kompetencën e KZK-ve. Këto përgjegjësi, ndër të tjera, përfshijnë emërimin dhe trajnimin e KZ-ve, verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët potencialë dhe regjistrimin e garuesve, si dhe nxjerrjen dhe shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve në nivel komunal.

²⁰ KZK-të e informuan MVZ-në e ODIHR-it se baza e të dhënave e softuerit për zyrtarët publikë është e vjetëruar dhe përmban të dhëna për persona të papërshtatshëm. Ata gjithashtu vunë në dukje se sistemi nuk përmban të dhëna kontakti, të cilat do t'u mundësonin KZK-ve të konfirmonin disponueshmërinë e anëtarëve të rinj të emëruar të KZ-ve.

²¹ MVZ-ja e ODIHR-it u informua se qendra nuk është krijuar ende për shkak të kufizimeve financiare dhe mosmarrëveshjeve midis drejtuesve aktualë të KSHZ-së në lidhje me statusin e saj.

KSHZ-ja ka miratuar një plan trajnimi që parashikon trajnimin e afërsisht 36,000 anëtarëve të KZK-ve dhe KZ-ve, mes 25 shtatorit dhe 15 tetorit.²²

VI. TË DREJTAT E VOTUESVE DHE REGJISTRIMI I TYRE

Të gjithë qytetarët e moshës 18 vjeç e lart kanë të drejtë vote, përveç atyre që u është hequr e drejta juridike me vendim përfundimtar të gjykatës ose që janë të dënuar për vepra të caktuara penale. Regjistrimi i votuesve është pasiv dhe strukturohet sipas komunës së vendbanimit të përhershëm të votuesve. Regjistri i votuesve (RV) mirëmbahet nga KSHZ-ja me ndihmën e Entit Shtetëror të Statistikave dhe bazohet në të dhënat nga regjistri qendror i popullsisë, i cili mirëmbahet nga Ministria e Transformimit Digjital në bashkëpunim me institucione të ndryshme.²³

Gjatë gjithë vitit, qytetarët mund t'i verifikojnë të dhënat e tyre në faqen e internetit të KSHZ-së ose personalisht në njërën nga zyrat rajonale të KSHZ-së. Përveç kësaj, para çdo zgjedhjeje, regjistri i votuesve është i disponueshëm për shqyrtim publik 15 ditë pas shpalljes së zgjedhjeve.²⁴ Pas kësaj, partitë politike kishin mundësinë të kërkonin një kopje elektronike të regjistrit për komunat në të cilat garojnë dhe mund të parashtronin kërkesa për korrigjime deri më 20 shtator.²⁵

Më 26 shtator, kur u mbyll për këto zgjedhje, regjistri i votuesve përfshinte të dhënat e 1.832.415 qytetarëve me të drejtë vote.²⁶ “Bashkëbiseduesit e Misionit të Vëzhgimit Zgjedhor të ODIHR-it vunë në dukje shqetësimet e kahershme lidhur me numrin e konsiderueshëm të votuesve që nuk banojnë në vendbanimin e tyre të përhershëm sipas regjistrit të votuesve, por jashtë vendit, si dhe me sistemin e paplotë dhe të vjetëruar të adresave të banimit, që mund të ndikojë në pjesëmarrjen e votuesve dhe në saktësinë e regjistrit të votuesve.”²⁷

VII. TË DREJTAT E KANDIDATËVE DHE REGJISTRIMI I TYRE

Qytetarët me të drejtë vote mund të kandidojnë për kryetar komune ose këshilltar në komunën e vendbanimit të tyre të përhershëm. Pavarësisht rekomandimeve të mëparshme të ODIHR-it, individët që aktualisht vuajnë ose presin ekzekutimin e një dënimi me burg prej më shumë se gjashtë muajsh vazhdon t'u ndalohej e drejta për të kandiduar për poste zyrtare. Kandidatët mund të emërohen nga partitë politike dhe koalicionet, ose nga grupet e votuesve.

Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese në maj të vitit 2025 që i shfuqizoi dispozitat e Kodit Zgjedhor mbi numrin e nënshkrimeve mbështetëse të nevojshme për kandidatët e pavarur, dhe pas dështimit të

²² Të gjithë anëtarët e KZ-ve janë të detyruar të marrin pjesë në trajnime, përndryshe kompensimi i tyre do të ulet për 20 për qind.

²³ Ofruesit kryesorë të të dhënave për regjistrin e popullsisë janë Drejtoria për Udhëheqjen e Librave Amë, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) dhe Regjistri Qendror. Në praktikë, KSHZ-ja e mirëmban RV-në vetëm në bazë të të dhënave dhe përditësimeve që i merr nga MPB-ja, pasi infrastruktura e saj e IT-së dhe bazat e të dhënave nuk janë të integruara në platformat e shkëmbimit të të dhënave ndërmjet agjencive.

²⁴ Këqyrja publike zgjati nga 23 gushti deri më 11 shtator, duke rezultuar në ndryshime në të dhënat e rreth 9.000 votuesve.

²⁵ Ndërkohë që partitë politike dhe garuesit e tjerë duhej të parashtronin kërkesa për të inspektuar listat e votuesve deri më 11 shtator, afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të tyre për regjistrim në KZK ishte 13 shtatori. Përmbajtja e informacionit të ndarë me partitë politike është e kufizuar vetëm në të dhënat e domosdoshme për këqyrje, siç janë emrat e votuesve, datat e lindjes dhe adresat. Në këto zgjedhje, gjashtë garues, nga të cilët pesë parti politike dhe një grup votuesish, kërkuan të dhëna nga lista e votuesve.

²⁶ Ekstraktet e listave zgjedhore për këto zgjedhje përmbajnë 1.717.803 votues. Votuesit që banojnë jashtë vendit, ata që janë në paraburgim dhe në institucionet e kujdesit për të moshuarit, që arrijnë në total prej 114.612 individësh, janë të përjashtuar nga listat.

²⁷ Në vitin 2007, menaxhimi i regjistrit të adresave u transferua nga Enti Shtetëror i Statistikave në Regjistrin Qendror. Në një përpjekje për të përmirësuar cilësinë e regjistrit të adresave, Regjistri Qendror kërkoj përditësime nga komunat, por deri tani ka marrë të dhëna vetëm nga 38 komuna (47,5 për qind).

parlamentit për të plotësuar boshllëkun e krijuar ligjor, KSHZ-ja miratoi një Rregullore më 17 gusht, e cila parashikon mbledhjen e vetëm dy nënshkrimeve mbështetëse mes 18 gushtit dhe 1 shtatorit. Ky veprim i KSHZ-së, dhe si pasojë, Udhëzimet e KSHZ-së për procedurat e dorëzimit dhe regjistrimit të listave të kandidatëve, u kundërshtuan pa sukses para Gjykatës Kushtetuese.²⁸

Dokumentet e kandidimit duhej të dorëzoheshin te KZK-të dhe KZQSh-ja deri më 13 shtator, me një afat dyditor për korrigjimin e mangësive.²⁹ Kodi Zgjedhor, kalendar i aktiviteteve të KSHZ-së dhe aktet e tjera nuk i rregullojnë qartë afatet e ndryshme kohore që zbatohen gjatë verifikimit të listave, gjë që çoi në një zbatim jo të njëtrajtshëm të procedurave të verifikimit nga KZK-të.³⁰ Përveç kësaj, KZK-të vunë në dukje se zbatimi i kërkesës ligjore për verifikimin e të dhënave penale të kandidatëve përmes gjykatave themelore ishte i ngarkuar dhe, nganjëherë, ndikoi në përgatitjet e tjera zgjedhore.³¹ KZK-të e informuan MVZ-në e ODIHR-it se gjykatat shpesh nuk e respektonin afatin ligjor prej 24-orësh për këto verifikime, duke shkaktuar vonesa të konsiderueshme në përpunimin e regjistrimeve të kandidatëve.³²

Të gjitha listat e kandidatëve u verifikuan para shortit të KSHZ-së më 24 shtator për të përcaktuar renditjen e garuesve në fletëvotime.³³ KZK-të dhe KZQSh-ja regjistruan gjithsej 10,490 kandidatë në 577 lista për këshillat komunalë, të parashtruara nga 27 parti politike, 6 koalicione dhe 65 grupe votuesish. Të gjitha listat e regjistruara të kandidatëve i plotësuan kërkesat për përfaqësim gjinor. Gratë përbëjnë rreth 45,1 për qind të të gjithë kandidatëve për këshilla dhe janë bartëse në 107 lista të kandidatëve (18,5 për qind). Gjithsej u regjistruan 309 kandidatë për kryetar komune, nga të cilët 79 u emëruan nga 19 parti politike, 176 nga 5 koalicione dhe 55 nga grupe votuesish; vetëm 32 (10,4 për qind) janë gra. KZK-të refuzuan gjashtë kandidatë për kryetar komune dhe katër lista këshillash, për shkak të dorëzimit me vonesë ose mangësive në dokumentet e emërimit; të gjitha ankesat kundër refuzimeve u hodhën poshtë nga Gjykata Administrative (shih *Zgjidhja e kontesteve zgjedhore*).

VIII. AMBIENTI I FUSHATËS

Periodha zyrtare e fushatës filloi më 29 shtator dhe përfundon më 17 tetor, me një periudhë heshtjeje zgjedhore prej 24-orëve para ditës së zgjedhjeve.³⁴ Zhvillimi i fushatës para afatit zyrtar është i ndaluar, por Kodi Zgjedhor u lejon garuesve të mbajnë një ngjarje publike mes kohës së regjistrimit të tyre dhe

²⁸ Shoqata "Kongresi Botëror Maqedonas" e kundërshtoi Rregulloren, duke argumentuar se KSHZ-ja i tejkaloi kompetencat e saj ligjore. Gjykata Kushtetuese refuzoi ta shqyrtonte kundërshtimin, duke theksuar se Rregullorja u miratua në një situatë vakumi ligjor, se ndiqte qëllimin legjitim për të respektuar të drejtat e garantuara të qytetarëve dhe ishte në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të majit të vitit 2025.

²⁹ Sipas KSHZ-së, kjo mundësi iu ofruar 8 kandidatëve për kryetar komune dhe 20 listave për këshilla komunalë.

³⁰ Për shembull, Kodi Zgjedhor nuk është i qartë se kur fillon afati 24-orësh për KZK-të për të verifikuar një listë të dorëzuar. Kalendar i aktiviteteve të KZSH-së parashikon se afati fillon në momentin kur lista dorëzohet. Disa KZK-e e informuan MVZ-në e ODIHR-it se kishin marrë udhëzim nga KSHZ-ja se afati 24-orësh fillon nga momenti kur KZK-ja merr përgjigje nga gjykata për dënimet e kandidatëve të emëruar.

³¹ Për shembull, KZK-të paralelisht duhej të zgjidhnin anëtarë të rinj të KZ-ve, një proces i ndërlikuar me shumë hapa (shih *Administrimi i zgjedhjeve*).

³² Verifikimet e të dhënave penale kryhen nga gjykatat themelore me juridiksion mbi vendlindjen e kandidatëve, dhe nga gjykata themelore e Shkupit për ata që kanë lindur jashtë vendit. Meqenëse informacioni mbi vendin e lindjes në letërnjoftime nuk është gjithmonë i saktë, kjo i detyroi KZK-të t'i kontaktonin drejtpërdrejt kandidatët e mundshëm. Ndryshe nga institucionet e tjera publike që kanë qasje automatike të drejtpërdrejtë në këto të dhëna, KZK-të duhej t'i kërkonin ato manualisht për secilin kandidat. 34 KZK i raportuan MVZ-së së ODIHR-it se ka pasur vonesa në përpunimin e kërkesave për të dhënat penale në gjykata.

³³ As ligji dhe as ndonjë akt tjetër nuk parashikon procedura të detajuara për shortin. Dispozitat ekzistuese ofrojnë udhëzime të kufizuara vetëm për listat e këshilltarëve, ndërsa kandidatët për kryetar komune nuk janë të përfshirë. Në praktikë, KSHZ-ja i ndau garuesit në tre nëngrupe: partitë parlamentare, partitë jo-parlamentare dhe ata të emëruar nga grupet e votuesve, dhe mbajti shorte të veçanta për të caktuar përkatësisht numrat nga 1 deri në 9, nga 10 deri në 33 dhe nga 34 deri në 153.

³⁴ Në komunat ku do të zhvillohet rrethi i dytë i zgjedhjeve për kryetar komune, fushata e rrethit të dytë do të zgjasë deri më 31 tetor, me një periudhë heshtjeje zgjedhore 24-orëshe para ditës së zgjedhjeve.

fillimit të fushatës zyrtare. Sipas disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it, disa kandidatë për kryetar komune u angazhuan në aktivitete të fushatës para fillimit zyrtar, duke përfshirë edhe në rrjetet sociale.

Ligji ndalon përdorimin e disa llojeve të burimeve shtetërore për zhvillimin e fushatës, duke filluar nga dita e shpalljes së zgjedhjeve.³⁵ Ekziston një ndalim i qartë për përdorimin e zyrave publike, pajisjeve dhe automjeteve zyrtare për qëllime të fushatës.³⁶ Megjithatë, aktivitetet e fushatës së bartësve të funksioneve publike mbeten të parregulluara.³⁷ Kodi Zgjedhor kërkon që të gjitha partitë politike që marrin pjesë në zgjedhje të nënshkruajnë Kodin për Zgjedhje të Drejta dhe Demokratike, i cili ndalon ushtrimin e presionit mbi nëpunësit shtetërorë dhe punonjësit e sektorit publik. Shumë bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it shprehën shqetësime në lidhje me keqpërdorimin e mundshëm të burimeve shtetërore gjatë fushatës, si dhe për presionin ndaj punonjësve të institucioneve shtetërore, ndërsa disa raportuan raste të pretenduara të transferimeve të punëtorëve ose kërcënimeve për largim nga puna në administratën publike.³⁸ Bashkëbisedues të shumtë të MVZ-së së ODIHR-it pretenduan se disa parti të mëdha i synojnë komunitetet e marginalizuara për blerje votash, dhe disa të tjerë pretenduan se ka blerje të vazhdueshme të votave, veçanërisht midis komuniteteve romë në kushte të pafavorshme ekonomike. Disa kandidatë të opozitës pretenduan se mbështetësit dhe bizneset e tyre përballen me inspektime administrative të synuara, kurse disa parti më të vogla ose kandidatë të pavarur raportuan se votuesit përballen me kërcënime për mbështetjen e tyre publike.

Kodi Zgjedhor e rregullon qasjen në reklamimin politik në hapësirat e jashtme, duke ndarë 80 për qind të hapësirës së disponueshme në mënyrë të barabartë për dy partitë kryesore të shumicës parlamentare dhe dy partitë kryesore opozitare, 10 për qind për partitë parlamentare pa grup parlamentar, dhe 10 për qind për partitë jo-parlamentare dhe kandidatët e pavarur. Sipas kësaj formule, partitë më të vogla me grup parlamentar nuk kanë të drejtë për përdorimin e hapësirës së reklamimit në ambient të jashtëm. Shumë bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it theksuan se ky rregullim i dëmton partitë joparlamentare dhe kandidatët e pavarur.

Zhvillimi i fushatës në rrjetet sociale nuk është i rregulluar në mënyrë të qartë, por ligji kërkon dallimin dhe etiketimin e të gjitha formave të reklamimit të paguar politik. Shumica e garuesve i deklaruan MVZ-së së ODIHR-it se do të mbështeteshin pjesërisht në rrjetet sociale për zhvillimin e fushatës. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it shprehën shqetësime në lidhje me ngacmimin në internet, duke përfshirë retorikën mizogjine kundër kandidateve gra, ndërsa disa bashkëbisedues raportuan se kishin pasur sulme verbale në rrjetet sociale në periudhën para fushatës.³⁹ Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it theksuan se niveli i ulët i njohurive mediatike mund ta bëjë publikun më të ndjeshëm ndaj

³⁵ Duke përfshirë ndalimet për përdorimin e fondeve publike për projekte të reja infrastrukturore, pagesa të jashtëzakonshme buxhetore dhe procedura për punësim publik, si dhe për inaugurimin e projekteve të financuara nga shteti duke filluar 20 ditë para fillimit të periudhës zyrtare të fushatës.

³⁶ Të gjitha institucionet publike duhet t'i raportojnë automjetet e tyre brenda dhjetë ditëve nga shpallja e zgjedhjeve në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK), gjegjësisht deri më 18 gusht. Para këtyre zgjedhjeve, automjetet e institucioneve publike morën targa të standardizuara për t'u dalluar nga automjetet private. KSHPK-ja [njoftoi](#) se deri më 29 shtator, vetëm 635 institucione i kishin dorëzuar të dhënat e kërkuara, ndërsa 879 nuk e kishin bërë këtë. Sipas ligjit, mosdorëzimi i të dhënave brenda afatit të parashikuar është i ndëshkueshëm me gjoba që variojnë nga 200 deri në 400 euro.

³⁷ Pas shpalljes së zgjedhjeve, KSHPK-ja i informoi institucionet shtetërore, zyrtarët publikë dhe garuesit mbi dispozitat ligjore për përdorimin e fondeve publike gjatë procesit zgjedhor. Ai gjithashtu njoftoi se do të monitorojë përdorimin e burimeve shtetërore gjatë fushatës dhe do t'i informojë autoritetet përkatëse për të ndërmarrë veprime kur të jetë e nevojshme.

³⁸ MVZ-ja e ODIHR-it pranoi pretendime të tilla në komunat e Koçanit, Novacit, Ohrit, Shuto Orizares dhe Tetovës.

³⁹ Më 9 shtator, MVZ-ja e ODIHR-it filloi monitorimin e llogarive në Facebook të disa partive politike, liderëve dhe kandidatëve për kryetar komune.

narrativeve të dezinformimit të përhapura në rrjetet sociale gjatë fushatës zgjedhore.⁴⁰ Manipulimi i mundshëm i informacionit nga jashtë gjatë procesit zgjedhor ishte gjithashtu një shqetësim për disa palë të përfshira.

Ligji nuk parashikon mbikëqyrje rregullatore për zhvillimin e fushatës në rrjetet sociale.⁴¹ Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike (ASHAAM) kishte hartuar një Kod vullnetar të Sjelljes në Hapësirën Online gjatë Proceseve Zgjedhore dhe Referendumeve, i cili, ndër të tjera, e trajton dezinformimin, retorikën intolerante dhe diskriminuese.⁴² ASHAAM-ja dhe homologët e saj kanë krijuar një organ koordinues, tek i cili mund të paraqiten ankesa në lidhje me shkeljet e Kodit.⁴³ Në janar të vitit 2025, qeveria miratoi Strategjinë e re për Sigurinë Kibernetike 2025–2028 dhe Planin e Veprimit, ndërsa në qershor, përmes një procedure të përshpejtuar, dhe për t'u harmonizuar me legjislacionin e BE-së për sigurinë e rrjeteve dhe sistemeve të informacionit, parlamenti miratoi Ligjin për Sigurinë e Rrjeteve dhe Sistemeve të Informacionit, i cili përcakton një sistem kombëtar për reagim ndaj kërcënimeve kibernetike dhe kërkon krijimin e Këshillit Kombëtar Koordinues për Sigurinë Kibernetike.⁴⁴

Ndërkohë që partitë politike që i përfaqësojnë komunitetet më të vogla etnike tradicionalisht janë bashkuar në koalicione zgjedhore me partitë e mëdha dhe e kanë bërë këtë edhe në këto zgjedhje, disa parti që i përfaqësojnë komunitetet serbe, turke, rome dhe boshnjake e informuan MVZ-në e ODIHR-it se kanë ndërmend të garojnë në mënyrë të pavarur.

IX. FINANCIMI I FUSHATËS

Financimi i fushatës dhe financimi politik janë të rregulluar kryesisht me Kodin Zgjedhor, Ligjin për Financimin e Partive Politike dhe Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktin e Interesave. Shumica e rekomandimeve të mëparshme të ODIHR-it mbeten të patrajtuara, duke përfshirë edhe ato që lidhen me raportimin e të gjitha të ardhurave dhe shpenzimeve për çdo njësi zgjedhore si në raportet e përkohshme ashtu edhe në ato përfundimtare, dorëzimin elektronik të raporteve të fushatës, rregullimin e kredive bankare dhe financimin nga palët e treta, kufizimet e rrepta për donacionet pas zgjedhjeve dhe sigurimin e burimeve të mjaftueshme për organet mbikëqyrëse.

Fushatat mund të financohen nga burime publike dhe private. Nuk ka financim të drejtpërdrejtë publik, por shteti, përmes KSHZ-së, i kompenson mediat e regjistruara transmetuese, të shkruara dhe ato online për reklamimin politik. Përveç kësaj, partitë politike që marrin financim nga shteti mund t'i përdorin këto fonde për qëllime të fushatës.⁴⁵

⁴⁰ Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike (ASHAAM) ka detyrim ligjor për të promovuar njohuritë mediatike. Ndër aktivitetet e tjera, në janar të vitit 2025, ajo publikoi një [Doracak për njohjen e dezinformative](#).

⁴¹ ASHAAM-ja e informoi MVZ-në e ODIHR-it se do të nisë një projekt pilot për rrethin e parë të zgjedhjeve lokale, duke monitoruar fushatën e palëve të treta në disa platforma të rrjeteve sociale.

⁴² Shih [Kodin e Sjelljes në Hapësirën Online gjatë Proceseve Zgjedhore dhe Referendumeve](#).

⁴³ Trupi koordinues përbëhet nga përfaqësues të ASHAAM-it, Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë, Institutit të Maqedonisë për Mediat, Këshillit për Etikë në Media të Maqedonisë, Institutit për Studime të Komunikimit dhe Fondacionit Metamorfozis.

⁴⁴ Shih [Strategjinë e Sigurisë Kibernetike 2025-2028 me Planin e Veprimit](#) dhe [Direktivën 2022/2555 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Evropës, të 14 dhjetorit të vitit 2022, mbi masat për një nivel të lartë të përbashkët të sigurisë kibernetike në të gjithë Bashkimin Evropian](#). Përveç kësaj, në qershor të vitit 2025, u miratua Ligji për Komunikimet Elektronike, i cili përmban dispozita që e forcojnë mbrojtjen e të dhënave personale.

⁴⁵ Sipas Ligjit për Financimin e Partive Politike, 0,15 për qind e të ardhurave vjetore të buxhetit të shtetit është caktuar për subvencione për partitë politike, ku 70 për qind u ndahen partive parlamentare, në mënyrë proporcionale me mandatet e tyre të deputetëve, dhe 30 për qind u ndahen në mënyrë të barabartë të gjitha partive kanë marrë të paktën një për qind të votave në zgjedhjet e fundit parlamentare ose lokale. Në vitin 2024, financimi shtetëror për partitë politike arriti në afërsisht 7,5 milionë euro. Ligji nuk i kufizon transferimet nga llogaritë e rregullta të partive në llogaritë e fushatës.

Financimi privat përfshin kredi bankare, të cilat nuk rregullohen në mënyrë gjithëpërfshirëse, dhe donacione monetare ose me natyrë tjetër, të kufizuara në 3,000 euro për individ dhe 30,000 euro për person juridik për çdo fushatë, në ekuivalent në denarë të Maqedonisë (MKD).⁴⁶ Donacionet nga burime të huaja, shtetërore, komunale dhe anonime, si dhe nga organizatat publike, fetare dhe ato bamirëse, janë të ndaluara. Ligji nuk e rregullon financimin e fushatave nga palët e treta. Shpenzimet e fushatës janë të kufizuara në 110 denarë (afërsisht 1,8 euro) për çdo votues të regjistruar në një komunë, që zbatohet për të dy rrethet e zgjedhjeve për kryetar komune. Për qëllime të financimit të fushatës, ligji nuk bën dallim midis zgjedhjeve për kryetar komune dhe për këshillat komunale.

Të gjithë kandidatët duhet të hapin llogari të dedikuar bankare, përmes të cilave përpunohen të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e fushatës. Mbikëqyrja e financimit të fushatave i është besuar Entit Shtetëror të Revizionit (ESHR) dhe Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK). Çdo garues duhet të dorëzojë tre raporte të përkohshme financiare, dy para ditës së zgjedhjeve dhe një pas saj, të cilat nuk i nënshtrohen revizionit.⁴⁷ Të gjitha raportet duhet të dorëzohen në ESHR, KSHPK dhe KSHZ, të cilat i publikojnë ato në faqet e tyre të internetit. Brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultateve zyrtare të zgjedhjeve, pjesëmarrësit e fushatës duhet të dorëzojnë një raport përfundimtar financiar tek ESHR-ja, e cila më pas ka 60 ditë kohë për t'i bërë revizion. Shablloni i raportimit u ofrua nga Ministria e Financave para zgjedhjeve të vitit 2024, por ai nuk kërkon ndarje sipas komunave. Kodi Zgjedhor parashikon gjoba deri në 9,000 euro për shkelje të rregullave të financimit të fushatës, duke përfshirë tejkalimin e kufirit për donacione ose shpenzime ose mosdorëzimin e raportit financiar.

Shumë bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it, duke përfshirë edhe ata nga institucionet mbikëqyrëse, shprehën shqetësime në lidhje me efektivitetin e mbikëqyrjes së financimit të fushatës dhe keqpërdorimin e burimeve administrative, duke përmendur boshllëqet sistemore në kornizën ligjore dhe kapacitetin e kufizuar të organeve mbikëqyrëse.⁴⁸

X. MEDIAT

Ambienti mediatik është i larmishëm, por i fragmentuar përgjatë vijave politike dhe etnike, dhe funksionon në një treg të kufizuar reklamash. Televizioni mbetet burimi kryesor i informimit politik, por portalet e lajmeve online dhe platformat e rrjeteve sociale kanë ndikim gjithnjë e më të madh. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it shprehën shqetësime në lidhje me mungesën e mediave lokale në disa pjesë të vendit. Ata gjithashtu vunë në dukje se për shkak të kushteve të pafavorshme të punës, burimet njerëzore në sektorin e medias janë të kufizuara, duke ndikuar si në kapacitetet gazetareske ashtu edhe në ato teknike. Ndryshimet e vitit 2025 në Ligjin për Mediat futën një përkufizim të mediave online dhe një regjistër vullnetar për mediat online, me qëllim të rritjes së transparencës.

Kushtetuta e garanton lirinë e shprehjes dhe të medias. Kodi Zgjedhor kërkon që mediat t'i mbulojnë zgjedhjet në mënyrë të drejtë, të balancuar, dhe të paanshme. Gjatë periudhës zyrtare të fushatës, transmetuesi publik - Radio Televizioni i Maqedonisë (RTM) është i obliguar t'i kushtojë 30 për qind të lajmeve ngjarjeve të përgjithshme, 30 për qind partive të shumicës parlamentare, 30 për qind opozitës

⁴⁶ 1 euro është përafërsisht 61,5 denarë.

⁴⁷ Raportet e përkohshme kërkojnë të raportohen vetëm donacionet e pranuar. Garuesit duhet ta dorëzojnë raportin e parë deri në ditën e 11-të të fushatës, të dytin deri në ditën para ditës së zgjedhjeve, dhe të tretin brenda një dite nga mbyllja e llogarisë bankare të dedikuar për fushatën. Në rast të mbajtjes së rrethit të dytë, kandidatët për kryetar komune duhet të dorëzojnë një raport të përkohshëm shtesë deri në ditën para zgjedhjeve të rrethit të dytë.

⁴⁸ Në [raportin e saj vjetor](#) të fundit, ESHR-ja rekomandoi disa ndryshime në rregullimin e financimit të fushatave, duke përfshirë ndalimin e donacioneve pas fushatës, rregullimin e shpenzimeve online dhe në rrjetet sociale, si dhe futjen e kriterëve më të rrepta të përshtatshmërisë për mediat që marrin fonde publike, duke përfshirë edhe portalet online. Gjithashtu, në [Raportin e saj pas zgjedhjeve të vitit 2024](#), KSHPK-ja i potencoi problemet lidhur me dorëzimin e vonuar ose jo të plotë të raporteve financiare, si dhe reklamimin e pa rregulluar digjital.

parlamentare dhe 10 për qind partive joparlamentare dhe kandidatëve të pavarur. RTM-ja gjithashtu duhet t'u ofrojë garuesve kohë transmetimi falas dhe të organizojë debate me kandidatët gjatë kohës me shikueshmëri më të madhe.

Kandidatët për kryetarë komune kanë të drejtë për mbulim të barabartë nga të gjithë transmetuesit, ndërsa dorëzuesit e listave për këshilltarë kanë të drejtë për mbulim të barabartë në mediat transmetuese lokale. Reklamat e paguara politike në media gjatë periudhës së fushatës financohen drejtpërdrejt nga buxheti i shtetit. Ngjashëm me rregullat për reklamim në hapësirë të jashtme, formula për shpërndarjen e fondeve dhe kohës së transmetimit të paguar nuk i parasheh partitë më të vogla që kanë grup parlamentar.⁴⁹ Më 26 shtator, pasi ASHMAA-ja miratoi udhëzimet për mediat elektronike mbi shpërndarjen e reklamave të paguara për zgjedhjet lokale, “Levica” (e Majta) parashtroi një kërkesë për masë të përkohshme në Gjykatën Themelore në Shkup, duke kërkuar ndalimin e zbatimit të udhëzimeve dhe që ASHMAA-ja lëshonte udhëzime të reja që do ta përfshinin partinë në formulën për shpërndarjen e reklamave të paguara politike.⁵⁰ Mediat që planifikojnë të ofrojnë kohë të paguar transmetimi duhet të regjistrohen në KSHZ.⁵¹ Transmetuesit kombëtarë janë të detyruar të sigurojnë qasshmëri për personat me aftësi të kufizuara në të paktën një edicion lajmesh në ditë dhe një program në javë në kohën me shikueshmëri më të madhe. ASHMAA-ja është e ngarkuar me rregullimin dhe mbikëqyrjen e mediave transmetuese, duke përfshirë monitorimin, dorëzimin e raporteve javore në KSHZ dhe publikimin në internet të gjetjeve të saj duke filluar nga shpallja e zgjedhjeve.

Më 15 shtator, MVZ-ja e ODIHR-it filloi monitorimin sasior dhe cilësor të transmetimeve në kohën me shikueshmëri më të madhe të shtatë stacioneve televizive kombëtare dhe analizën cilësore të artikujve që kanë të bëjnë me zgjedhjet në pesë faqe lajmesh në internet.⁵²

XI. ZGJIDHJA E KONTESTEVE ZGJEDHORE

Ankesat që lidhen me zgjedhjet mund të parashtrohen në KSHZ, KZK-të, gjykatat themelore, ose në KSHPK, varësisht nga çështja. Shumica e ankesave mund të parashtrohen vetëm nga kandidatët; votuesit mund të parashtrojnë ankesa vetëm në lidhje me keqpërdorimin e burimeve administrative edhe atë në KSHPK, dhe në lidhje me shkeljet e të drejtave të tyre individuale të votimit në KSHZ para ditës së zgjedhjeve dhe në KZK në ditën e zgjedhjeve. Gjykatat themelore dhe KSHZ-ja trajtojnë lloje të ndryshme të shkeljeve që lidhen me fushatën. KSHZ-ja gjithashtu i shqyrton ankesat e garuesve në lidhje me votimin, përmbledhjen e rezultateve dhe rezultatet e zgjedhjeve. Ajo mund të fillojë procedurat për parregullsi zgjedhore sipas detyrës zyrtare (*ex officio*) dhe t'i përcjellë veprat e dyshuara penale në prokurori. Vendimet e KSHZ-së, KZK-ve dhe KSHPK-së mund të apelojnë në Gjykatën Administrative, ndërsa gjykatat e apelit i shqyrtojnë ankesat ndaj vendimeve të gjykatave themelore që

⁴⁹ Kodi Zgjedhor përcakton që 8 minuta nga çdo bllok reklamash me pagesë prej 9.5 minutash dhe 90 për qind e fondeve të ndara për fushatën në media duhet të ndahen në mënyrë të barabartë midis dy partive më të mëdha në pushtet dhe dy partive më të mëdha të opozitës parlamentare, 1 minutë dhe 7 për qind e fondeve u ndahen partive parlamentare që nuk kanë numër të mjaftueshëm deputetësh për të formuar grup parlamentar, ndërsa 30 sekonda dhe 3 për qind e fondeve duhet të ndahen midis partive joparlamentare dhe kandidatëve të pavarur.

⁵⁰ Sipas ligjit, gjykatat duhet të veprojnë me procedurë të përsheptuar dhe kanë tre ditë kohë për të vendosur për kërkesat e tilla. Nëse kërkesa pranohet, masa e përkohshme skadon pas 15 ditësh. Më 30 shtator, Gjykata Themelore në Shkup e shpalli veten jo kompetente për këtë rast, duke thënë se do t'ia përcjellë atë Gjykatës Administrative si gjykatë kompetente, për veprim të mëtejshëm. “Levica” gjithashtu parashtroi një kundërshtim ndaj Udhëzimeve të ASHAAM-së në Gjykatën Kushtetuese më 29 shtator, dhe e informoi MVZ-në e ODIHR-it se kishte dorëzuar një propozim në parlament për ndryshimin e Kodit Zgjedhor dhe plotësimin e boshllëkut ligjor.

⁵¹ Për këto zgjedhje, në KSHZ u regjistruan 33 stacione televizive, 42 radio-stacione, 8 gazeta të përditshme dhe 246 media online. Bashkëbiseduesit e MVZ-së së ODIHR-it shprehën shqetësime në lidhje me transparencën e disa mediave online të regjistruara në KSHZ.

⁵² Monitorimi i MVZ-së së ODIHR-it i përfshin transmetuesit publikë *RTM 1* dhe *RTM 2* (në gjuhën shqipe), transmetuesit privatë *Alfa*, *Alsat-M* (në gjuhën shqipe), *Kanal 5*, *Sitel* dhe *Telma*, si dhe portalet e lajmeve online *kurir.mk*, *plusinfo.mk*, dhe *slobodenpecat.mk*, së bashku me *tetotavsot.com* dhe *lajmpress.org* (në gjuhën shqipe).

lidhen me zgjedhjet.⁵³ Afatet për dorëzimin e kundërshtimeve variojnë nga 12 orë deri në 2 ditë, me ç'rast lejohen 1 deri në 3 ditë për shumicën e shqyrtimeve.⁵⁴ Disa bashkëbisedues të MVZ-së së ODIHR-it, duke përfshirë edhe nga gjyqësori, theksuan se disa afate janë tepër të shkurtra, duke e dëmtuar potencialisht cilësinë e vendimeve.⁵⁵

Gjykata Kushtetuese e shqyrton kushtetutshmërinë e akteve ligjore apo vendimeve që lidhen me zgjedhjet, mirëpo për këtë nuk është paraparë procedurë e përsheptuar. Megjithatë, pas shpalljes së zgjedhjeve lokale, Gjykata shqyrtoi disa iniciativa në lidhje me këto zgjedhje, duke përfshirë Rregulloren e KSHZ-së që rregullon mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për kandidatët e pavarur, Udhëzimet e KSHZ-së për procedurat e dorëzimit dhe regjistrimit të listave të kandidatëve, dhe vendimin e qeverisë për numrin e këshilltarëve për çdo komunë (shih *Regjistrimi i kandidatëve dhe Korniza ligjore dhe sistemi zgjedhor*, përkatësisht). Gjykata i hodhi poshtë të gjitha iniciativat. Deri më sot, Gjykata Administrative ka shqyrtuar dy kundërshtime në lidhje me refuzimin e dy kandidatëve për kryetar komune dhe një liste për këshill dhe i miratoi vendimet e KZK-ve.

Shumica e bashkëbiseduesve të MVZ-së së ODIHR-it shprehën besim në efikasitetin e sistemit të zgjidhjes së kontesteve, megjithëse disa prej tyre shprehën shqetësime në lidhje me paanshmërinë dhe pavarësinë e organeve gjykuere.⁵⁶

XII. VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE

Kodi Zgjedhor parashikon si vëzhgimin qytetar ashtu edhe atë ndërkombëtar të zgjedhjeve. Përfaqësuesit e akredituar të shoqatave qytetare të regjistruara të paktën një vit para ditës së zgjedhjeve, statutet e të cilave parashikojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut, organizatat ndërkombëtare dhe përfaqësuesit e vendeve të huaja, mund t'i vëzhgojnë të gjitha aspektet e procesit zgjedhor. Aplikimet për akreditimin e vëzhguesve duhet të dorëzohen në KSHZ jo më vonë se dhjetë ditë para ditës së zgjedhjeve. Garuesit në zgjedhje mund të emërojnë përfaqësues të autorizuar në komunat ku garojnë, duke aplikuar në KZK-në përkatëse deri tre ditë para ditës së zgjedhjeve për të ndjekur procesin zgjedhor në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore.

Aktivitetet e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat vëzhguese qytetare janë shumë të kufizuara për shkak të mungesës së fondeve, gjë që nuk i lejon të shpërndajnë një numër të konsiderueshëm vëzhguesish afatgjatë dhe afatshkurtër. Në vend të kësaj, ata përqendrohen në aktivitete të tilla si monitorimi i mediave dhe rrjeteve sociale, ndikimi i huaj i mundshëm dhe fushata të dezinformimit, keqpërdorimi i burimeve shtetërore, marrëdhëniet ndërmjet bashkësive dhe qasshmëria e procesit zgjedhor.⁵⁷

⁵³ Ekzistojnë katër Gjykata të Apelit në Maqedoninë e Veriut, me seli në Shkup, Manastir, Gostivar dhe Shtip.

⁵⁴ Kundërshtimet votuesve në ditën e zgjedhjeve duhet të parashtrihen brenda 12 orëve dhe të shqyrtohen brenda 2 orëve.

⁵⁵ Seksioni h II.3.3(95) i [Raportit Shpjegues të Kodit të Praktikës së Mirë](#) të Komisionit për Demokraci përmes Ligjit të Këshillit të Evropës (Komisioni i Venedikut) thotë se afatet kohore duhet [...] të zgjasin aq sa për të garantuar ushtrimin e së drejtës për ankesë, si dhe marrjen e një vendimi të peshuar mirë. Një afat kohor prej tri deri në pesë ditë në instancën e parë (duke përfshirë parashtrimin e ankesës dhe marrjen e vendimit) duket se është i arsyeshëm”.

⁵⁶ Sipas [Raportit të Komisionit Evropian për Sundimin e Ligjit për vitin 2024](#), vetëm 25 për qind e publikut të gjerë dhe 20 për qind e kompanive i konsiderojnë gjykatat mjaft ose shumë të pavarura. Gjithashtu, në [Raporti e Zgjerimit për vitin 2024](#) për Maqedoninë e Veriut, Komisioni Evropian vuri në dukje se “...duhet të përmirësohen pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit. Ndërhyrjet e jashtme ose politike mbetet një shqetësim serioz. Niveli i perceptuar i besimit në gjyqësor mbetet shumë i ulët.”

⁵⁷ Nga dy organizatat kryesore të vëzhguesve qytetarë që më parë kanë qenë të përfshira në vëzhgimin e zgjedhjeve, 'Shoqata e Qytetarëve MOST' nuk do të shpërndajë vëzhgues, ndërsa 'CIVIL – Qendra për Liri' planifikon të shpërndajë 6 vëzhgues afatgjatë dhe 60 vëzhgues afatshkurtër në ditën e zgjedhjeve. Grupe të tjera aktive përfshijnë organizatat në komunitet si “Romët për Demokraci” dhe “Umbrella”, si dhe organizatat lokale si “Zeta” dhe “Polio+”, të cilat përqendrohen në të drejtat dhe përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara dhe qasshmërinë e

XIII. AKTIVITETET E MVZ-SË SË ODIHR-IT

MVZ-ja e ODIHR-it në Shkup u hap më 5 shtator. Misioni është takuar dhe ka vendosur kontakte të rregullta me KSHZ-në dhe KZK-të, Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe të Tregtisë së Jashtme, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Ministrinë e Transformimit Digjital, institucionet qeveritare dhe shtetërore të përfshira në procesin zgjedhor, gjyqësorin, Prokurorin e Përgjithshëm, partitë politike, kandidatët, shoqërinë civile, mediat dhe komunitetin diplomatik dhe ndërkombëtar të vendosur në vend. Vëzhguesit afatgjatë të MVZ-së së ODIHR-it janë takuar me palët e interesuara në nivel lokal që nga shpërndarja e tyre më 13 shtator.

Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale i Këshillit të Evropës dhe Parlamenti Evropian kanë njoftuar qëllimin e tyre për të dërguar një delegacion vëzhguesish për ditën e zgjedhjeve më 19 tetor.

*Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar.
Janë në dispozicion përkthime jozyrtare në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.*